VENDIM
Nr. 632, datë 7.9.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PEDONALJA "ABAZ BEJ LUSHNJA""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Pedonalja "Abaz Bej Lushnja"".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 12 165 523 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 12 165 523 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT, "RIKOSNTRUKSION I RRUGËS "PEDONALJA "ABAZ BEJ LUSHNJA""

Nr	Pronari		Zona Kadastrale	Nr. pasurise	Lloji i ndertimit	Siperfaqja		Cmimi		Vlera		Vlera gjithsej truall+ndrtese	Konfirmimi i ZVRPP-se
	Emer	Mbiemer				Truall	Ndertese	Truall	Ndertese	Truall	Ndertese		
						m2	m2	lek	lek	lek	lek		
1	Nuri	Beqiri	8571	18/136+1-1,-2,-3	Banese	0	292	9709	40100	0	11709200	11709200	Konfirmuar Nr.4941/1prot,dt 15.06.2016
2	Nuri	Beqiri+ bashk.	8571	18/180	Truall	47	0	9709	0	456323	0	456323	Konfirmuar Nr.4941/1prot,dt 15.06.2016
										Shuma total		12165523	

Shenim : Siperfaqa e truallit o z.Nuri Beqiri+Bashkepronare eshte 115m2 dhe kesaj siperfaqe eshte zbritur gjurma e nderteses se katit perdhe te baneses prej 68m2 te z.Nuri Beqiri .